



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 maj 2014
Nr. ref.:RK636/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI15/14

Parashtrues

Reshat Murati

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit
të Gjykatës së Apelit, CA. nr. 2453/2012, të 27 marsit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Reshat Murati (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Mitrovicë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, CA. nr. 2453/2012, i 27 marsit 2013, i cili i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 2 maj 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, CA. nr. 2453/2012, të 27 marsit 2013, me të cilin ishte refuzuar ankesa e parashtruesit të kërkesës si e pabazuar dhe ishte vërtetuar Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2533/09. Me aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë hidhet poshtë si e paafatshme padia e parashtruesit të kërkesës për kthim në vendin e tij të punës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 28 janar 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 7 shkurt 2014, me Vendimin GJR. KI15/14, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, me Vendimin KSH. KI15/14, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 19 shkurt 2014, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën e Apelit për kërkesën.
8. Më 11 mars 2014, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë që të sigurojë një kopje të fletëkthesës, e cila tregon se kur i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, CA. nr. 2453/2012, i 27 marsit 2013.
9. Më 19 mars 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën, e cila tregon se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, CA. nr. 2453/2012, i 27 marsit 2013, i është dorëzuar përfaqësuesit ligjor të parashtruesit të kërkesës më 2 maj 2013.
10. Më 12 maj 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Prej vitit 1970 e deri më 2004, parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar në Kompaninë e Sigurimeve “Dardania” në Prishtinë, trashëgimtare e Kompanisë “Dunav” (në tekstin e mëtejme: punëdhënësi).
12. Në vitin 2004, punëdhënësi e vendosi parashtruesin e kërkesës në listën e punëtorëve të paangazhuar, me një kompensim prej 50 eurosh në muaj.
13. Më 13 nëntor 2009, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë për kthim në vendin e tij të punës.
14. Më 4 maj 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktvendimin C. nr. 2533/09, e hodhi poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës si të paafatshme, sepse parashtruesi i kërkesës e kishte dorëzuar padinë e tij në Gjykatë, duke kërkuar kthimin e tij në punë më 13 nëntor 2009, ndërsa marrëdhënia e punës ndërmjet tij dhe punëdhënësit kishte përfunduar më 2004. Pas ankesës së dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës, më 27 mars 2013, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin CA. nr. 2453/2012, e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2533/09, të 4 majit 2011.
15. Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, CA. nr. 2453/2012, i 27 marsit 2013, i ishte dorëzuar përfaqësuesit ligjor të parashtruesit të kërkesës më 2 maj 2013.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës, pa saktësuar shkeljen e pretenduar të ndonjë dispozite konkrete kushtetuese, kërkon: “[...] të ndërpritet dhuna, dhe presioni ndaj meje dhe familjes sime dhe diskriminimi i pa par ndaj meje [...]”.

Pranueshmëria e kërkesës

17. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
18. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, që parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.
19. Për të vërtetuar nëse parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesë brenda afatit të paraparë prej katër muajsh, Gjykata i referohet datës së marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e parashtruesit të kërkesës dhe datës së dorëzimit të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

20. Nga parashtruesat del se aktvendimi i Gjykatës së Apelit iu dorëzua përfaqësuesit ligjor të parashtruesit të kërkesës më 2 maj 2013, ndërsa parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 28 janar 2014.
21. Në rastin konkret, Gjykata vëren se periudha katërmuajshe fillon të rrjedhë nga data në të cilën përfaqësuesi ligjor i parashtruesit të kërkesës ishte në dijeni për vendimin (Shih rastin *Çelik kundër Turqisë*, kërkesa nr. 52991/99, GJEDNJ, Vendimi i 23 shtatorit 2004).
22. Bazuar në sa u tha më sipër, rezulton se kërkesa nuk është paraqitur brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.
23. Prandaj, kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme, sepse është e paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, më 12 maj 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani